



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE**  
**KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE**

---

Nr. 5 Prot

Tiranë, më 18/02 2013

**VENDIM Nr. 3 dt. 13.02.2013**

Në mbështetje të nenit 17, pika 6, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, ndryshuar me ligjin nr. 9882, dt 28.02.2008, "Për Trashëgiminë Kulturore", Këshilli Kombëtar i Restaurimeve në mbledhjen e datës 13.02.2013, pasi shqyrtoi projektet e diskutuara në Institutin e Monumenteve të Kulturës, sipas pikave të rendit të ditës:

**Lidhur me pikën e diskutimit: Shqyrtimi i projekteve:**

**VENDOSI:**

1. **Miratohet:** Projekti i restaurimit të afreskut të demtuar të kishës së Shën e Premtes Valesh, Elbasan me kondicionin:
  - KKR kërkoi zhvillimin e një ekspertize me profesionistë të huaj (UNESCO, Itali, Francë), lidhur me mënyrën e plotësimit të afreskut në hapësirat, pjesët e të cilave mungojnë. Zgjidhja përfundimtare do të diskutohet në mbledhjen e radhës së KKR.
2. **Miratohet:** Projekt restaurimi i fasadave të Pazarit të Korçës.
3. **Miratohet:** Projekt restaurimi i mureve të manastirit të shën Pjetrit në Vithkuq të Korçës, me vërejtjen: **(Të kryhen punimet konsoliduese, pa shtuar volume).**
4. **Miratohen:** Projekte për ndërhyrje emergjence (shpëtimi) në:
  - Afreskët e kishës së Shën Mërisë në Gollomboç të Korçës.
  - Afreskët e kishës së Shën Mëhillit në Shalës të Kolonjës.
  - Afreskët e varrit romak në kanalën e Vivarit, Butrint Sarandë.

5. **Miratohet:** Projekt konservimi dhe restaurimi i katedrales “Fjetja e Shën Mërisë”, sot “Muzeu Onufri”, Berat.

6. **Nuk miratohet:** Projekt restaurimi çatish në tre lagjet e Qendrës historike, Berat.  
(Të ripunohet grafikisht projekti dhe të rishqyrtohet në Këshillin Shkencor).

7. **Miratohet varianti i dytë për:** Projekt konservimi dhe restaurimi banesa e Llavdës, sot “Muzeu Etnografik” T-01, Berat

8. **Miratohet:** Projekti i Portës së Pashait, Porta e re e shkollës “7 Nëntori” dhe kangjellat mbrojtëse, Berat

9. **Miratohet:** Projekt restaurimi të banesës së Rexhep Karajt, Fushë-Bulqizë.

10. **Miratohet:** Projekti banesa e Sul Hupit, Fushë Bulqizë, Dibër.

- Ngarkohet sekretaria teknike, për njoftimin e këtij vendimi.
- Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR  
ALDO BUMÇI**



**SEKRETAR I KKR  
AKADEMIK. APOLLON BAÇE**

